

VENDIM
Nr.1321, datë 1.10.2008

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, TË PRONËS SË
PALUAJTSHME, SHTETËRORE, NDËRTESA 2 KATE, ZYRA, GARAZH DHE
VENDROJË, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, NË KËTË QYTET, DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.359, DATË 5.6.2003 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV SHTETËROR”, E PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.431, DATË 11.7.2007 “PËR MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË I
TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, BASHKISË GRAMSH, TË
QARKUT TË ELBASANIT” TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3/a, 5, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë Gramsh, të pronës së paluajtshme, shtetërore, ndërtesa 2 kate, zyra, garazh dhe vendroje, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Informativ të Shtetit, në këtë qytet, për t’u përdorur për ngritjen e një qendre sociale.
 2. Bashkisë së Gramshit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
 3. Prona me nr.7 të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.359, datë 5.6.2003 të Këshillit të Ministrave.
 4. Prona, ndërtesa 2 kate, zyra, garazh dhe vendroje, e Shërbimit Informativ të Shtetit, Gramsh, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave.
 5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Gramsh për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Shërbimi Informativ i Shtetit							Identifikoi: Xhelal Abedini, kryetar dege, Ylli Goxhaj, ing. ndërtimi (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Bashkia: Gramsh							Supervizoi: Bardhyl Rrapaj, drejtor i Drejtorisë Ekonomike (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Fusha e përdorimit të pronës: Zyra dhe ambiente të tjera ndihmëse							Aprovoi: Petrit Myftari, i ngarkuar ligjor me detyrën e drejtorit të SHISH-it (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma,vula)			

	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastr. & indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Emërtesa e pronës, vendndodhja / shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
7			Godinë 2 kate zyra dhe garazh vendrojtë Gramsh				Zyra pune ambiente shërbimi	Drejtoria SHISH Elbasan	Kati I-rë e ka në përdorim bashkia	Dhënë me kontratë qiraje me autorizim nr.21, datë 21.3.2001 drejtorit të SHISH Elbasan
7/a				Godinë 2 kate	Gramsh	264				
7/b				Vendrojtë	“	9				
7/c				Oborr	“	1050				